



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Punëdhënësi / Prodator Received / Delivery	30 - 03 2022	viti god year
Organ / Agjencia Organ / Jednica Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	Shtojca Prilog Appendix
SKPM/SHCK	1708/2022	1116



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 10 /2022
Datë: 30.03.2022

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2. 4 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, si dhe nenin 2 paragrafi 5 të Rregullores Nr.02/2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.04/2018, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (Këshilli) në mbledhjen e pestë (V) të mbajtur më datë 30.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Raporti i Kolegjit të Këshillit lidhur me vlerësimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për vitin 2020 në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë.
2. Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë obligohet për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandime është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Jeton KOCA
Kryetar i Këshillit

Vendimi i dërgohet:

- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë
- Udhëheqësit të Sektorit të Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe
- Arkivit të Këshillit.



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planimar / Dorezuar Priljefta/Prodato Received/Delivered	30.03.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPSHICK	1408/2022		1115

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I MONITORIMIT
PËR VITIN 2020

në

AGJENCINË E USHQIMIT DHE VETERINARISË

Prishtinë, 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBAJTJE.....	2
HYRJE.....	3
FUNKSIONI I MONITORIMIT.....	3-4
OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT.....	4
FUSHA E MONITORIMIT.....	4-5
RAPORTI I MONITORIMIT NË AGJENCINË E USHQIMIT DHE VETERINARISË.....	5-15

HYRJJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tutje referuar si Këshilli) është institucion i themeluar me Kushtetutë, me mandat specifik për sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.

Këshilli, mandatin e tij kushtetues, sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil e realizon përmes funksioneve themelore të përcaktuara me nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si:

- ❖ shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidateve për pranim në shërbimin civil;
- ❖ monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Këshilli, funksionet dhe përgjegjësitë themelore i ushtron në pajtim me:

- ❖ Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
- ❖ Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- ❖ Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë;
- ❖ Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;
- ❖ Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative;
- ❖ Rregulloren Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- ❖ Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- ❖ Rregulloren Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.
- ❖ Rregulloren Nr.05/2018, Për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

FUNKSIONI I MONITORIMIT TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE

Krahas funksionit të shqyrtimit dhe vendosjes së ankesave të nëpunësve civil dhe kandidateve për pranim në shërbimin civil, Këshilli ushtron edhe funksionin e monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Ketë funksion e ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe dispozitat e Rregullos Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit në Institucionet e Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

Këshilli, përmes ushtrimit të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike, mbikëqyrë zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil me qëllim të krijimit të një administratë publike, profesionale dhe efikase, sipas standardeve me të mira evropiane.

Funksioni i monitorimit ushtrohet përmes monitorimit të rregullt që realizohet sipas planit vjetor të monitorimit, dhe përmes monitorimit të jashtëzakonshëm që realizohet në raste të veçanta që ndërlidhen me shkelje të rënda të legjislacionit për shërbimin civil.

Këshilli, në procesin e monitorimit të institucioneve të administratës publike përgatit raport me të gjetura dhe rekomandime dhe nxjerr vendim, të cilin së bashku me raport ia dërgon institucionit përkatës. Institucioni përkatës i administratës publike është i obliguar për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit, brenda afatit të përcaktuar me vendimin e Këshillit.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Përmes ushtrimit të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike Këshilli siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë për realizimin e objektivës sonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

FUSHAT E MONITORIMIT

Këshilli, me qëllim të ushtrimit të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e monitorimit.

Sipas Rregullores Nr.04/2018 për procedurën e monitorimit në institucionet e administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, fushat të cilat monitorohen nga Këshilli janë:

- ❖ Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- ❖ Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- ❖ Procedurat disiplinore;
- ❖ Procedurat e ankesave;
- ❖ Procedurat e vlerësimit;
- ❖ Procedurat e pushimeve;
- ❖ Procedurat e transferimit;
- ❖ Të dhënat lidhur me përfaqësimin etnik, gjinor dhe personave me nevojë të veçanta;
- ❖ Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- ❖ Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- ❖ Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale apo është i dënuar me vendim të gjykatës;

- ❖ Trajnimi i nëpunësve civil;
- ❖ Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- ❖ Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- ❖ Ngacmimet Seksuale;
- ❖ Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Monitorimin e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil

RAPORT I MONITORIMIT TË LIDHUR ME ZBATIMIN E RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL, NË AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË

Këshilli, gjatë procesit të monitorimit së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë për të vlerësuar drejtë në mënyrë të pa anshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, përveç monitorimit të drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë të realizuar me datë 21.01.2022, në prezencë të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore, si mostra për shqyrtim ka marr një mori të kopjeve të dokumenteve relevante, si në vijim:

Rregullorja Nr.01/2011 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë; Vendimi Ref.AUV 835/2020 i datës 16.12.2020 për caktim të ushtrueses së detyrës; Akt emërimi i nëpunëses në pozitën “Zyrtare për Shëndetin e Kafshëve” i datës 13.10.2017 me numër 6710/1; Vendimi Ref.AUV 01-172/2020 i datës 11.03.2020 për caktim të ushtrues së detyrës; Akt emërimi i nëpunësit në pozitën “Analist i Buxhetit” i datës 26.10.2016 me numër 6694; Vendimi Ref.AUV 01-076/2019 i datës 01.03.2019 për themelimin e Komisionit Disiplinor; Vendimi Ref.AUV 01-269/2019 i datës 01.07.2019 për themelimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Vendimi Ref.AUV 516/2020 i datës 18.09.2020 për shfuqizimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Ankesa e nëpunësit e datës 13.01.2020 me numër 105 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës; Procedimi i ankesës me numër të protokollit 105 të datës 13.01.2020; Vendimi Ref.AUV i datës 14.02.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Kërkesa për rivlerësim të rezultatit të punës e datës 19.12.2019; Formulari për vlerësimin e rezultatet të punës për vitin 2019 për nëpunësin në vendin e punës “Koordinator i Zyrës Rajonale në Mitrovicë”; Ankesa për vendimin 65-2020 të AUV-së e datës 10.02.2020 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Vendimi Ref.AUV 01-004/2020 i datës 10.01.2020 për caktim të detyrave shtesë në Drejtorinë e Inspektionit; Procedimi i ankesës me numër të protokollit 1115 të datës 10.02.2020; Ankesa e datës 02.06.2020 m3 numër 2943 kundër Vendimit 62-2020 të AUV-së; Vendimi me Ref.AUV-01/199/2020 i datës 30.03.2020 për caktim të detyrave shtesë në Drejtorinë e Inspektionit; Procedimi i ankesës me numër të protokollit 2943 të datës 02.06.2020; Vendimi Ref.AUV 002/2020 i datës 09.01.2020 për shfrytëzimin e pushimit mjekësor pa pagesë; Kërkesa e datës 13.23.2019 për aprovim të pushimit mjekësor pa pagesë; Raportet mjekësore të lëshuara nga Ambulanca Specialistike ALERGJIA-ASTMA e datave: 13.12.2019, 26.11.2019, 18.06.2018; Fletlëshimi me Epikrizë nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës e datës 21.03.2018; Fletlëshimi nga Klinika Universitare e Kosovës e datës 17.04.2018; Raporti i datës 12.12.2019 e lëshuar

nga KAVAJA HOSPITAL; Raporti i datës 12.12.2019 e lëshuar nga KAVAJA HOSPITAL; Vendimi me Ref.AUV 01-187/20 i datës 30.03.2020 për vazhdim të pushimit mjekësor pa pagesë; Vendimi Ref.AUV 303/2020 i datës 10.06.2020 për pushim pa pagesë; Kërkesa e datës 03.10.2019 për pushim pa pagesë; Vendimi Ref.AUV 01-062/2020 i datës 05.02.2020 për pushim të lehonisë; Vendimi Ref.AUV 616/2020 i datës 28.10.2020 për pushim të lehonisë; Vendimi Ref.AUV 489/2020 i datës 07.09.2020 për pushim të lehonisë; Vendimi REF.AUV 626/2020 i datës 04.11.2020 për pushim të lehonisë; Vendimi Ref.AUV 611/2020 i datës 26.10.2020 për pushim pa pagesë të lehonisë; Vendimi Ref.AUV 024/2020 i datës 23.01.2020 për transfer;Akt emërimi i nëpunëses në pozitën "Asistente Administrative"Vendimi Ref.AUV 362/2020 i datës 23.07.2020 për transfer; Vendimi Ref.AUV 01/359/20 i datës 21.07.2020 për transfer;Akt emërimi i nëpunësit në pozitën "Inspektor Fitosanitar" i datës 01.04.2014;Vendim Ref.AUV 420/2020 i datës 25.08.2020 për caktim në pozitë;Akt emërimi i nëpunëses në pozitën "Nëpunëse Civile e Nivelit Profesional";Vendimi Ref.AUV 01-360/20 i datës 21.07.2020 për transferim;Vendim Ref.AUV 01-181/2018 i datës 21.05.2018 për transferim; Akt emërimi i ankuesit në pozitën "Nëpunës Civil i Nivelit Profesional" i datës 01.04.2014;Vendim Ref.AUV 01-025/2020 i datës 23.01.2020 për transferim;Akt emërimi i nëpunëses në pozitën "Asistente Administrative";Vendim Ref.AUV 664/2020 i datës 12.11.2020 për transferim; Akt emërimi i nëpunëses në pozitën "Inspektor Fitosanitar" i datës 01.12.2015;Vendim Ref.AUV 665/2020 i datës 12.11.2020 për transferim; Akt emërim i nëpunësit në vendin e punës "Inspektor Fitosanitar" i datës 01.04.2014;Vendim Ref.AUV 534/2020 i datës 28.09.2020 për transferim;Akt emërim për pozitën "Zyrtare Deposite" e datës 20.07.2018;Vendim Ref.AUV 01-325/2020 i datës 30.06.2020 për ndërprerje të marrëdhënies së punës;Marrëveshje e datës 29.06.2020 për transferin e përhershëm; Vendim Ref.AUV 01-013/2020 i datës 20.01.2020 ndërprerje e marrëdhënies së punës;E-mail i datës 15.01.2020 për lirim të vendit të punës;Akt emërim për nëpunësen në vendin e punës "Zyrtare për Pranimin e Mostrave" e datës 02.12.2013;Vendimi Ref.AUV-01/613/2010 i datës 28.10.2020 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës;E-mail i datës 21.10.2020 për dorëheqje;Akt emërim i nëpunëses në pozitën "Kimiste", i datës 01.03.2013;Vendim Ref.AUV 01-804/2020 i datës 03.12.2020 ndërprerje e marrëdhënies së punës;E-mail i datës 30.11.2020 kërkesë për ndërprerje të marrëdhënies së punës;Akt emërim për nëpunësen në pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Nënprodukteve Shtazore" i datës 09.09.2015;Vendim Ref.AUV 01-149/2020 i datës 06.03.2020 për përfundim të marrëdhënies së punës;Vendimi Ref.AUV 01-147/2020 i datës 06.03.2020 kompensimi i pagës për pensionim;Akt emërimi i nëpunëses në pozitën "Zyrtare Certifikues" i datës 08.12.2014;Vendim Ref.AUV 01-195/2020 i datës 25.03.2020 përfundim i marrëdhënies së punës;Vendim Ref.AUV 01-194/2020 i datës 25.03.2020 për kompensimin e pagës për pensionim;Akt emërimi i nëpunësit në pozitën "Inspektor Sanitar" i datës 01.04.2014;Vendim Ref.AUV 01-382/2020 i datës 13.08.2020 përfundim i marrëdhënies së punës;Vendim Ref.AUV 01-382/1/2020 i datës 13.08.2020 për kompensimin e pagës për pensionim;Akt emërimi i nëpunësit në pozitën "Udhëheqës i Zyrës Ligjor" i datës 05.08.2015;Kërkesë për udhëtim zyrtar e datës 02.01.2020;Urdhër Obligimi për Pagesë i datës 11.02.2020;Akt emërimi i nëpunësit në pozitën "Shef i Sektorit të Inspektoratit Fitosanitar Kufitar" i datës 08.07.2013;Kërkesë për udhëtim zyrtar i datës 20.01.2020; Urdhër Obligimi për Pagesa data 11.02.2020;Vendim Ref.AUV 01-491/2019 i datës 08.10.2019 për caktimin e ushtruesit të detyrës;Akt emërimi i nëpunësit në pozitën "Inspektor Sanitar" i datës 23.03.2012;Kërkesë për

udhëtim zyrtar i datës 20.01.2020;Urdhër Obligimi për Pagesa datë 11.02.2020;Akt emërimi i nëpunësit në pozitën "Inspektor Fitosanitar" i datës 01.04.2014;Kërkesë për Udhëtim Zyrtar i datës 28.02.2020;Urdhër Obligimi për Pagesë i datës 05.05.2020;Akt emërim i nëpunëses në pozitën "Biologe" i datës 02.12.2013;Kërkesë për Udhëtim Zyrtar i datës 28.02.2020;Urdhër Obligimi për Pagesë i datës 05.05.2020;Akt emërim i nëpunësit në pozitën "Zyrtare për Shëndetin e Kafshëve" i datës 13.10.2017;Kërkesë për udhëtim zyrtare i datës 30.01.2020;Urdhër Obligimi për pagesë i datës 27.02.2020;Akt emërimi i nëpunësit në pozitën "Inspektor Veterinar" i datës 01.04.2014;Kërkesë për Udhëtim Zyrtar i datës 10.02.2020;Urdhër Obligimi për Pagesë i datës 23.04.2020;Akt emërimi i nëpunësit në pozitën "Shef i Inspektionit Veterinar Kufitar" i datës 04.01.2013;Kërkesë për Udhëtim Zyrtar i datës 30.01.2020;Urdhër Obligimi për Pagesë i datës 24.02.2020;Akt emërimi i nëpunësit në pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Bakteriologjisë, Parazitologjisë dhe Mikologjisë" e datës 23.08.2013;Raporti periodik i evidencës së hyrjeve dhe daljeve për periudhë 01.09.2020-01.09.2020;Lista e vijueshmërisë në punë e datës 28.09.2020, 19.10.2020-23.10.2020, 02.11.2020-06.11.2020 i Sektorit të Identifikimit dhe Regjistrimit; Akt emërimi i nëpunësit në pozitën "Shef i Inspektionit Veterinar Kufitar" i datës 04.01.2013;Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës për nëpunësit civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ultë dhe profesional për vitin 2020;Kërkesa për pushim vjetor e nëpunësit në pozitën Shef i Inspektionit Veterinar Kufitar" i datës 04.01.2013;Akt emërimi i nëpunësit në pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Inspektoratit Sanitar" i datës 31.01.2013;Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës për nëpunësit civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ultë dhe profesional për vitin 2020;Kërkesa për pushim vjetor e nëpunësit në pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Inspektoratit Sanitar" i datës 31.01.2013;Akt emërimi i nëpunësit në pozitën "Zyrtar për Shëndetin e Kafshëve" i datës 13.10.2017;Vendimi Ref.AUV 835/2020 i datës 16.12.2020 për caktimin e ushtrimit të detyrave;Kërkesa për pushim mjekësor e datës 30.01.2020 si dhe raporti mjekësor;Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës për nëpunësit civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ultë dhe profesional për vitin 2020;Akt emërimi i nëpunësit në pozitën "Inspektor Veterinar Kufitar" i datës 01.04.2019;Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës për nëpunësit civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ultë dhe profesional për vitin 2020;Vendimi Ref.AUV 055/2021 i datës 01.02.2021 për aprovim të koeficientit;E-mail i datës 29.01.2021;Kërkesa për pushim vjetor;Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës për nëpunësit civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ultë dhe profesional për vitin 2020;Formulari i Planit Individual të Personelit.

Këshillit për procedurën e monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e monitorimit të përfshira në "pyetësor", ka konstatuar të gjeturat dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të institucionit si në vijim:

1. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës që ka bërë në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë më datë 21.01.2022, ka konstatuar që ky institucion e ka në fuqi Rregulloren Nr.01/2012 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë të datës 27.03.2012 me numër të protokollit 1246/1. Numri i nëpunësve civilë të miratuar më buxhetin e institucionit për vitin 2020 ka qenë njëqind e tetëdhjetë e një (181) ndërsa pozita të lira kanë qenë trembëdhjetë (13) ndërsa numri i nëpunësve aktual është njëqind e gjashtëdhjetë e katër (164).

Gjatë vizitës Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka shqyrtuar dosjet e personelit dhe ka konstatuar se dosjet e personelit janë të kompletuara, ndërsa nga dosjet e nëpunësve civilë janë larguar pushimet e nëpunësve sepse kanë kaluar në arkiv me arsyetimin që dosjet mos të jenë shumë voluminoze mirëpo ato iu kanë prezantuar Kolegjit të Këshillit për monitorim. Dhe po ashtu janë shqyrtuar pesë (5) dosje të nëpunësve civil; E.SH i sistemuar në vendin e punës "Shef i Inspektionit Veterinar Kufitar"; I.T i sistemuar në vendin e punës "Udhëheqës i Sektorit të Inspektoratit Sanitar"; S.A Draga e sistemuar në vendin e punës "Zyrtare për Shëndetin e Kafshëve"; A.L i sistemuar në vendin e punës "Inspektor Veterinar Kufitar" dhe A.S i sistemuar në vendin e punës "Inspektor Veterinar".

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

Ushtruesit e detyrës: Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë duke u bazuar në dëshmitë e ofruara ka konstatuar se në këtë institucion gjatë vitit 2020 ka pasur dy (2) pozita të ushtruesve të detyrave dhe po ashtu ka pasur tejkalim të afatit ligjor.

E GJETURA 1: Gjatë vizitës Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë gjatë shqyrtimit të vendimeve ka konstatuar se Vendimi Ref.AUV 01-172/2020 i datës 11.03.2020 për caktimin e ushtruesit të detyrës në vendin e punës "Zyrtar Certifikues", është në kundërshtim me dispozitat e nenit 30 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"Në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës nuk mund, të emërohet më gjatë se tre (3) muaj"*, ndërsa sipas Vendimit Ref.AUV 835/2020 i datës 16.12.2020 për zëvendësim të "Udhëheqësit të Sektorit të Nënprodukteve Shtazore" është në kundërshtim me dispozitat e nenit 32 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *"Përjashtimisht, një pozitë e rregullt pune në Shërbimin Civil mund të plotësohet në rast të nevojës të zëvendësimit apo mungesës së përkohshme të një nëpunësi civil varësisht nga rasti, për një periudhë jo më të gjatë se 12 (dymbëdhjetë) muaj. Në këtë rast, procedurat e pranimit zhvillohen nga Njësia e Burimeve Njerëzore, në pajtim me rregullat e përcaktuara me këtë ligj për nëpunësin administrativ dhe mbështetës"*.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Kryeshefin Ekzekutiv të Agjencisë e Ushqimit dhe Veterinarisë që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për eliminimin e shkeljes së lartë cekur që në raste të zëvendësimeve të nëpunësve civilë të veprohet në pajtim me dispozitat e nenit 32 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ka pasur planë vjetorë të rekrutimit për vitin 2020 mirëpo nuk ka zhvilluar asnjë procedurë të rekrutimit apo të avancimit të nëpunësve civilë, po ashtu Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë nuk ka pasur nëpunës të angazhuar me marrëveshje për shërbime të veçanta.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

3. PROCEDURAT DISIPLINORE

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, ka konstatuar se me datë 01.03.2019 është themeluar Komisioni Disiplinor me Vendimin me numër Ref.AUV 01-076/2019 ku në pikën e katërt (IV) të këtij vendimi është theksuar se Komisionit Disiplinor i përfundon mandati me datë 28.02.2021 ndërsa Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë nuk ka nxjerr vendim të ri për themelimin e Komisionit Disiplinor. Ndërsa gjatë vitit 2020 nuk kanë zhvilluar asnjë procedurë disiplinore. Lidhur me këtë fushë kemi konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 2: Kolegji për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të Vendimit të Komisionit Disiplinor me Ref.AUV 01-076/2019 e datës 01.03.2019 ka konstatuar se Komisioni Disiplinor nuk ka mandat për shqyrtimin e çështjeve disiplinore, andaj Komisioni Disiplinor duhet të themelohet në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 49 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka përcaktuar se: *"Në çdo institucion, në fushën e veprimit të këtij ligji, themelohet një komision disiplinor me mandat 3 vjeçar, që përfshin së paku një përfaqësues të njësisë përgjegjëse",* dhe në pajtim me nenin 10 paragrafin 2 nën paragrafin 2.1, 2.2 dhe 2.3 dhe paragrafi 3 i Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë i cili ka përcaktuar se: *"2. Komisioni disiplinor përbëhet nga tre (3) anëtarë të cilët duhet të jenë nëpunës civilë, nga të cilët njëri duhet të jetë jurist dhe ka këtë përbërje: 2.1. Nëpunës civil i nivelit drejtues – Kryesues i Komisionit; 2.2. Nëpunës civil i nivelit profesional – anëtar dhe 2.3. Nëpunës civil i njësisë së burimeve njerëzore – anëtar". Kryesuesi dhe anëtarët e komisionit disiplinor emërohen nga Udhëheqësi më i Lartë Administrativ i Institucionit me një mandat 3 vjeçar.*

Rekomandimi 2: Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë për themelimin e Komisionit Disiplinor në pajtim me dispozitat e nenit 49 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe në pajtim me nenin 10 paragrafin 2 nën paragrafin 2.1, 2.2 dhe 2.3 dhe paragrafit 3 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

4. PROCEDURAT E ANKESAVE

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e ka pas të themeluar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave sipas Vendimit me numër Ref.AUV 269/2019 të datës 01.07.2019 i cili Komisionin ka qenë i themeluar me tre (3) anëtar të përherëshëm me mandat dy (2) vjeçar që ka qenë në pajtim me nenin 82 paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Kolegji për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka konstatuar se në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë kanë pasur tri (3) ankesa të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave.

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Zëvendës Kryeshefi Ekzekutiv me datë 18.09.2020 ka nxjerr Vendimin me numër Ref.AUV 516/2020 të datës 18.09.2020 me të cilin Vendim është shfuqizuar Vendimi për Themelimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i datës Ref.AUV 269/2019 të datës 01.07.2019.

E GJETURA 3: Kolegji për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka konstatuar se në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë kanë pasur tri (3) ankesa të parashtruara në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, prej të cilave vetëm njëra është vendosur dhe dy (2) të tjera nuk janë vendosur kështu që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat të nenit 9 paragrafit 7 të Rregullores Nr.05/2010 për Procedurat e Zgjedhjes së Kontesteve dhe të Ankesave që ka përcaktuar se: *"Komisioni duhet të marr vendim brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të ankesës"*, rrjedhimisht Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave duhet ti ketë shqyrtuar të gjitha rastet e parashtruara për Komision.

Këshilli për monitorim, për kundër që ka konstatuar këtë të gjetur lidhur mos shqyrtimin e ankesave nga ana e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, nuk ka dhënë rekomandim pasi që lidhur me ankesat e nëpunësve civilë ankesat parashtrohen drejtpërsëdrejti në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sipas Ligjit Nr.06/-114 për Zyrtarët Publikë.

5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, për vitin 2020 për njëqind e pesë te tre (153) nëpunës civile ka bërë vlerësimin ndërsa njëmbëdhjetë (11) prej tyre nuk janë vlerësuar si dhe kemi vlerësime të cilat nëpunësi civil i ka pranuar jashtë afatit të përcaktuar ligjor siç është rasti tek nëpunësi civil i sistemuar në vendin e punës "Inspektor Veterinar Kufitar" sipas akt emërimit me numër të protokollit 1534 të datës 01.04.2014 si dhe të formularët e vlerësimeve janë të nënshkruar nga nëpunësit civil mirëpo nuk është e shkruar data kur nëpunësi e ka pranuar vlerësimin siç është gjetur tek rastet e nëpunësit civil i sistemuar në vendin e punës "Shef i Inspektionit Veterinar Kufitar" sipas akt emërimit me numër të protokollit 033 të datës 04.01.2013 dhe tek nëpunësi i punësuar në vendin e punës "Udhëheqës i Sektorit të Inspektoratit Sanitar" sipas akt emërimit me numër të protokollit 367/1 të datës 31.01.13.

E GJETURA 4: Kolegji për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil gjatë shqyrtimit të vlerësimeve të rezultateve në punë ka konstatuar se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë vlerësimin e rezultateve në punë e ka bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 43 paragrafi 1 Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se *“Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues.”* Dhe me dispozitat e nenit 8 paragrafi 2 i Rregullore Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike ku përcaktohet se *“Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin paraprak”.*

Rekomandimi 3: Rekomandohet Kryeshefi Ekzekutiv dhe Udhëheqësi i Sektorit të Personelit, që vlerësimet e rezultateve në punë për nëpunësit civil në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, të bëhen në pajtim me dispozitat e nenit 43 paragrafi 1 Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat e nenit 8 paragrafi 2 i Rregullore Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë evidencën e pushimeve të nëpunësve civil e mban në formë fizike dhe elektronike, tridhjetë e pesë (35) nëpunës kanë realizuar pushimin mjekësor dhe në dosje kanë qenë të vendosura shenjat mjekësore, dy (2) pushime pa pagesë dhe pesë (5) nëpunëse civile kanë realizuar pushimin lehonisë. Për lejimin e pushimit pa pagesë dhe ato të lehonisë, Vendimit janë nxjerrë pas kërkesave të parashtruara nga nëpunësit civil duke ia bashkangjitur edhe dokumentacionin përkatës për lejimin e pushimit andaj edhe Kryeshefi Ekzekutiv këto vendimi i ka nxjerr duke i respektuar dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë, Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës.

Tek pushimet vjetore, Kolegji gjatë shqyrtimit të dosjeve ka vërejtur se nëpunësit civil kërkesat për realizimin e pushimit vjetor i bëjnë përmes sistemit SIMBNJ.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, gjatë vitit 2020 ka pasur tetë (8) transfere të përhershme brenda Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë dhe një (1) transferim ka qenë i jashtëm me marrëveshje në mes Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë dhe Ministrisë së Mbrotjtjes, dhe në bazë të shqyrtimit të dosjeve, kemi konstatuar se procedurat kanë qenë në pajtim me legjislacionin e shërbimit civil në fuqi.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, janë të punësuar njëqind e katërdhjetë e nëntë (149) shqiptar, trembëdhjetë (13) serb, një (1) boshnjak dhe një (1) turk ndërsa pesëdhjetë e katër (54) prej tyre janë femra dhe njëqind e nëntë (109) meshkuj mirë po në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë nuk ka nëpunës me nevoja të veçanta.

Në bazë të vlerësimeve në këtë fushë është konstatuar kjo e gjetur;

E GJETURA 5: Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej njëqind e gjashtëdhjetë e tre (163) nëpunësve civil të punësuar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, nuk ka asnjë nëpunës me nevoja të veçanta, e po ashtu nuk është barazia gjinore në mes meshkujve dhe femrave, e që nënkupton se nuk ka numër të mjaftueshëm të punësuar në pajtim të barabartë të punësuarve në aspektin gjinor ashtu siç është e përcaktuar me dispozitat e nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr.05/L-020 për Barazi Gjinore që përcakton se: *“Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse”,* po ashtu Kolegji ka konstatuar se me dispozitat e nenit 12 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara ka përcaktuar se: *“Çdo punëdhënësi është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor”.*

Rekomandim 4: Rekomandojmë Kryeshefin Ekzekutiv që të ndërmarrë veprime në pajtim me dispozitat e nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr.05/L-020 për Barazi Gjinore si dhe me dispozitat e nenit 12 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.

9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, ka pasur gjashtë (6) ndërprerje të marrëdhënies së punës prej të cilave tri (3) ndërprerje të marrëdhënies së punës kanë qenë për shkak të dorëheqjes dhe tri (3) për shkak të arritjes së pensionimit. Kolegji ka konstatuar se në rastet e dorëheqjes së nëpunësve civile janë nxjerr tre Vendimet për ndërprerje të marrëdhënies së punës pas kërkesave të nëpunësve për dorëheqje po ashtu edhe të ndërprerja e marrëdhënies së punës janë nxjerr Vendimet për ndërprerje për shkak të pensionimit si dhe ju ka kompensuar një pagë në vlerën e pagës së fundit.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë nuk ka asnjë nëpunës civil i cili në të njëjtën kohë mbanë ndonjë post publik.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, nuk kanë pasur raste të nëpunësit civil që është duke u zhvilluar procedurë penale .

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, për vitin 2020 e ka pas Planin Individual të trajnimeve dhe se evidenca e trajnimeve mbahet në formë elektronike dhe fizike. Plani i trajnimeve është dërguar në MAP/DASHC me datë 24.02.2020 dhe në të njëjtën ditë është pranuar nga MAP/DASHC ndërsa sa i përket trajnimeve me pagesë ka pasur tetë (8) nëpunës civilë që kanë ndjekur trajnimet me pagesë.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

13. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë vijimin në punë e mban në formë elektronike mirëpo për pikat kufitare mbahet në formë fizike sepse sipas arsyetimit të Udhëheqësit të Personelit Ministria e Administratës Publike nuk iu dërgon sistemin elektronik pa qenë tridhjetë (30) veta. Po ashtu në bazë të shqyrtimit të listës së pagave konstatohet se të gjitha pagat realizohen në pajtim me akt emërimet ndërsa kompensimet që aplikohet për nëpunësit civil janë shtesat e zyrtarëve të teknologjisë të informative dhe për të gjithë stafin shtesa për rrezikshmëri në punë.

E GJETURA 6: Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, sipas deklaratimit të Udhëheqësit të Personelit të gjithë nëpunësit civil kanë shtesa për rrezikshmëri në punë.

Rekomandim 5: Rekomandojmë Kryeshefin Ekzekutiv që kompensimet eventuale të nëpunësve civil të bëhen konformë Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe rregulloren 33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil dhe aktet tjera të nxjerra duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

14. NGACMIMET SEKSUALE

Gjatë vizitës së monitorimit nuk na është raportuar asnjë rast sa i përket kësaj çështje dhe nuk kemi ndonjë rekomandim.

15. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Këshilli për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, ka pranuar një vendim të Këshillit për vitin 2020.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

**16. SHËNIMET/KOMENTET/KONKLuzionET E PËRGJITHSHME
PËRPROCEDURAT E MONITORIMIT TË INSTITUCIONEVE TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE LIDHUR ME ZBATIMIN E RREGULLAVE DHE
PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL**

Këshilli gjatë shqyrtimit të provave dhe disa dosjeve me rastin e vizitës në këtë institucion, për fushat e monitorimit, ka konstatuar gjashtë (6) të gjetura dhe ka dhënë pesë (5) rekomandime.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon Kryeshefin Ekzekutiv dhe Udhëheqësen e Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, që gjetjet me rekomandimet e dhëna në këtë raport t'i adresoj dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

I dërgohet:

- ❖ Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë;
- ❖ Udhëheqësit të Sektorit të Personelit të dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK.